



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA E KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
Nr. Prot. _____
Br. Prot. 03-03/3757/16
Prot No. _____
Nr. I faq. _____
Broj stranica _____
Data _____
Date 14.10.2016
Nr. pages 02
Datum _____
Date _____
PRISHTINE

DATË/A:	14.10.2016
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP 03-03/3551/16
PËR/ZA/TO:	z. Bujar KUÇI, Shef i zyrës së Prokurimit në Komunën e Suharekës
CC:	z. Sali ASLLANAJ, Kryetar i Komunës së Suharekës,
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Ndërtimi i rrugës Jemin Sinani në Nishor – vazhdim "



I nderuari z. Kuçi ,

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nënpar. 1.1. dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nënpar. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nënpar. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin "Ndërtimi i rrugës Jemin Sinani në Nishor – vazhdim " me numër të prokurimit: 624-16-107-536, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "**Ndërtimi i rrugës Jemin Sinani në Nishor – vazhdim**" me numër të prokurimit: **624-16-107-536**, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Agjencia) me datë 06.10.2016, ka nxjerrë vendim me numër protokolli *AKK-03-03-3551/16* për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "**Ndërtimi i rrugës Jemin Sinani në Nishor – vazhdim**" me numër të prokurimit: **624-16-107-536**, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Komuna e Suharekës. Agjencia, me datë 10.10.2016, ka paraqitur kërkesën për dokumentacion, ku ka kërkuar nga Autoriteti kontraktues t'a dorëzojë në Agjenci, dokumentacionin përkatës për këtë aktivitet të prokurimit para hapjes së tenderëve.

Agjencia kundër Korrupsionit, pasi ka analizuar me kujdes dosjen e tenderit, konstaton se autoriteti kontraktues ka paraparë kontratë për punë ndërtimore me vlerë të vogël të cilën e ka zhvilluar në procedurë të kuotimit të çmimeve, veprim ky i cili bie ndesh me dispozitat e Ligjit në fuqi për prokurimin publik. Agjencia, konsideron se autoriteti kontraktues nuk ka zgjedhur procedurën e duhur për realizimin e punëve për këtë projekt. Sipas nenit 36 të Ligjit në fuqi për prokurimin publik paragrafi 1 dhe pika 1.1 thuhet decidivisht se **“Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat për kuotimin e çmimeve për të ushtruar një aktivitet të prokurimit që ka për qëllim dhënien e një kontrate të punëve, furnizimeve ose shërbimeve me vlerë minimale ose të vogël, në rast të kontratave për punë përfshinë vetëm riparime apo mirëmbajtje”**. Sipas këtij Ligji nuk lejohet që me procedurën e kuotimit të çmimit të realizohen punë ndërtimore.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti kontraktues që t'i evitoj dhe të mos i përsëris shkeljet e tilla në të ardhmen.

Veprimet e autoritetit kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin, nenin **27** dosja e tenderit, si dhe nenin **36** Procedurat për kuotimin e çmimeve të Ligjit për prokurimin publik nr.04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237 dhe ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !